



REPUBLIKA E SHQIPERISE
TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. ~~622~~ Prot

Berat, më 09.12.2021

URDHËR

Nr. 29, datë 09.12.2021

**NISJA E PROCEDURËS SË PROKURIMIT DHE NGRITJA E GRUPIT TË PUNËS
PËR HARTIMIN E TERMAVE TE REFERENCES & DOKUMENTAVE
STANDARD PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË PUNIMIT ME OBJEKT,
“QUALITY FOR ACCESS FOR ALL PILOT RESTORATIONS” NË KUADËR TË
PROJEKTIT “ACCESSIBLE TOURISM”, PERKATESISHT (DELIVERABLE 5.4.2)
FINANCIAR NGA PROGRAMI INTERREG IPA TË BASHKËPUNIMIT
NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI, 2014-2020”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe nenit 64 kompetencat e Kryetarit të Bashkisë, të Ligjit Nr. 37/2015 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë”, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II) dhe Ligjit Nr. 137/2016, datë 22.12.2016, Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020, Pjesa IV, Neni 33, si dhe bazuar në Marrëveshjen e Partneritetit të Projektit dhe udhëzuesin praktik të procedurave të prokurimit të aksioneve të jashtme “PRAG”, versioni Gusht 2020.

URDHËROJ:

1. Fillimin e procedurës së prokurimit, bazuar në rregullat e përcaktuara nga Komisioni Evropian për procedurat e prokurimit të përcaktuara në PRAG (Guida Praktike për procedurat e kontraktimit), versioni Gusht 2020, paragrafi 2.6.1 “Cila procedurë aplikohet?” “Kontratw punime me vlerë < EUR 300 000, por > EUR 20 000 paragrafi 2.6.4. “Procedurë e thjeshtuar (simplified)” si dhe paragrafi 5.2.3, paragrafi 5.6 dhe 5.8, si më poshtë:

Kontratë punimi “Quality for Access for all Pilot Restorations” në kuadër të projektit “Accessible Tourism”, e parashikuar në paketen e punës Punime Infrastruktura (wP5), me një buxhet maksimal të parashikuar prej 50,000 EUR (pa TVSH).

2. Ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë prej:

1. Marius Qytyku
2. Valentina Karabina
3. Marinela Llupa
4. Orges Bozaxhiu
5. Ardisa Zhuka



REPUBLIKA E SHQIPERISE
TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Të hartojnë termat e references dhe dokumentet e tjere standarde për shpalljen e garës për këtë shërbim.

3. Njësia e prokurimit të ndjekë procesin e hartimit të dokumenteve standarde, përgatitjen e dosjes së tenderit sipas rregullave të PRAG, versioni 2020 paragrafi 5.2.3; 5.6 dhe paragrafi 5.8, për zhvillimin e procedurës së prokurimit për këtë objekt si dhe shpalljen e garës se metejshme.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ERVIN DEMO

